



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 60 dt.08.05.1995

PER
KALIMIN NE KONSERVIM TE NJE PJESE TE KAPITALIT
TE NDERMARRJES GALANTERISE

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.08.05.1995, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Seksioni i Prognozës “Mbi kalimin në konservim të një pjese të kapitalit të Ndërmarrjes së Galanterisë”, mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.47, dt.07.02.1994

VENDOSI

1. Të aprovojë një fond page për 5 roje dhe e përgjegjësit të tyre i cili kryen aktivitetin e drejtimit dhe administrimit të punës dhe pasurisë.
2. Fondi i pagës për rojet fillon nga muaji shkurt 1995 deri në muajin qershor 1995.
3. Fondi total për 5 muaj plus shtesat aprovet 174.946 lekë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA